



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
(*Një profil i shkurtër*)





Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

(Një profil i shkurtër)

Prishtinë, 2011

I nderuari lexues,



Në duart tuaja keni një botim i cili ka për qëllim të ju sjellë informacione për organizimin e AMM-së, njësitë përbërëse, detyrat dhe përgjegjësitë si dhe disa nga rezultatet dhe të arriturat kryesore që nga themelimi e deri sot.

Edhe pse AMMK është një institucion i vogël për nga numri i stafit dhe i resurse tjera, funksionalizimi i tij ka

sjellë një kontribut të çmueshëm në avancimin, përmirësimin dhe në përsheptimin e zgjidhjes së shumë çështjeve të mbrojtjes e mjedisit në Kosovë.

Me themelimin e AKMM-së, është adresuar në mënyrë më profesionale monitorimi i gjendjes së mjedisit, është ngritur baza e një sistem të informimit mjedisor, janë prodhuar të dhëna dhe informata kualitative për gjendjen e mjedisit, si dhe është bërë vlerësimi real i gjendjes së mjedisit dhe i ndikimeve të sektorëve të ndryshëm në mjedis.

Nga të dhënat e grumbulluara janë përgatitur Raporte profesionale për gjendjen e mjedisit. Përmes informacione mbi gjendjen dhe kualitetin e ajrit, ujit, dheut, mbi gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit, mbi relacionet e mjedisit dhe shëndetit, mbeturinat e informacione të tjera relevante

AKMM-ja ka ofruar mundësi për nxjerrjen e përfundimeve dhe rekomandimet për përcaktimin e politikave mjedisore të së ardhmes, dhe për ndërmarrjen e masave mbi preventivën dhe kontrollin mjedisor

Përmes aktiviteteve të saj, AMMK ka adresuar shumë çështje dhe probleme mjedisore dhe ka ofruar alternativa për zgjidhjen e tyre.

Dhënia e ndihmës profesionale në të gjitha fushat mjedisore për MMPH, por edhe për palët tjera të interesuara është një ndër aktivitetet më të rëndësishme të AKMM-së.

AMMK ka vënë edhe themelet e bashkëpunimi edhe me Agjencionin Evropian të Mjedisit dhe me shumë institucione tjera të rëndësishme ndërkombëtare.

Është më së e qartë, se asnjë Institucion, agjenci a organizatë, qoftë qeveritare apo jo qeveritare, nuk mund të kryej me sukses misionin e saj, pa bashkëpunimin e ngushtë, të hapur dhe konstruktiv me institucionet e tjera relevante.

Prandaj, edhe suksesi i AKMM, është ngushtë i varur nga bashkëpunimi me institucionet tjera qeveritare, me komunat, me operatorët ekonomik, me OJQ dhe me institucionet e ndryshme hulumtuese e profesionale.

Me këtë rast falënderojmë të gjitha institucionet dhe bashkëpunëtorët për bashkëpunimin dhe përkrahjen e ofruara për AMMK-në në projektet, angazhimet dhe organizmet tona.

Dr.sc Ilir Morina Kryeshef Ekzekutiv

Misioni

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) është institucion qeveritarë i cili angazhohet që përmes monitorimit të integruar të mjedisit, sistemit efikas të informimit mjedisorë dhe raportimit të vazhdueshëm për gjendjen e mjedisit, të ruajë kualitetin e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit, të promovojë shfrytëzimin e burimeve të ripërtritshme të energjisë dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore me qëllim që të sigurojë një mjedis të shëndetshëm për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme në harmoni me progresin e zhvillimeve ekonomike dhe sociale.

Vizioni

Monitorim, informim dhe raportim efikas mjedisorë, për një mjedis të shëndetshëm dhe rritje ekonomike të qëndrueshme.

Misioni dhe vizioni i AMMK-së



Themelimi

Në kuadër të plotësimit të infrastrukturës institucionale dhe ngritjes së efektivitetit dhe rezultateve në mbrojtjen e mjedisit MMPH ka themeluar AMMK-së si një institucion shumë të rëndësishëm.

AKMM është themeluar me ligjin për mbrojtjen e mjedisit (2003/9, neni 39, pika 1) " ...si institucion në kuadër të MMPH, për kryerjen e punëve administrative, profesionale, mbështetëse shkencore dhe kërkimore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, zonave të mbrojtura të natyrës, të diversitetit biologjik...".

Fillimisht organizimi i Agjencisë është bërë me Udhëzim Administrativ nr. Rendor 25, nr. Protokollit 22/03.

Me 06.06.2006 është emëruar Kryeshefi Ekzekutiv. Me vendimin e Ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nr. Rendor 03/07, nr. Protokoli 38 të datës 05.06.2006, është funksionalizuar AKMM dhe është kompletuar stafi me personel adekuat.

Personeli është marrë nga MMPH, duke u bërë lëvizshmëri e brendshme e stafit në përputhje me Rregulloren nr. 2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Vetëqeverisjes së Kosovës.

Me 5 Qershor të vitit 2011, me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Mjedisit, AMMK ka shënuar 5 Vjetorin e themelimit të saj. Në kuadër të kësaj dite janë organizuar aktivitete të ndryshme.

Për shkak të problemeve dhe pengesave të caktuara administrative, financiare, kadrovike etj, AKMM ka mund të filloj funksionin e saj të plotë, vetëm në Qershor 2007.

Në vitin 2011, në kuadër të riorganizimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë bazuar në Planin Strategjik Zhvillimor 2010-2014 të MMPH-se dhe në vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 09/26, Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ Nr.13, për Strukturën Organizative dhe Përgjegjësitë e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Sipas këtij udhëzimi administrative AMMK është e organizuar në Institute, Drejtori, Divizione, Sektorë dhe Njësi.

Institutet në kuadër të AMMK-së janë: Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe Instituti i Planifikimit Hapësinorë, ndërsa Drejtoritë në kuadër të AMMK-së janë: Drejtoria e Monitorimit, Vlerësimit dhe Raportimit Mjedisor dhe Drejtoria e Parqeve Kombëtare.



Detyrat dhe Përgjegjësitë e AMMK-së


AMMK ka për detyrë monitorimin e gjendjes së mjedisit dhe të natyrës, krijimin dhe udhëheqjen e bazës së të dhënave dhe sistemin e informimit mjedisor. Po ashtu AMMK ka detyrë të jep mendime profesionale në procedurën e miratimeve të planeve menaxhuese për zonat e mbrojtura të natyrës, propozon zgjidhjet profesionale tekniko-teknologjike për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe natyrës, përgatitë plane dhe programe në fushën e mbrojtjes së mjedisit, përcjell zbatimin e planeve të veprimit në mjedis, jep mendimin profesional në planet hapësinore dhe urbanistike, përgatitë raportin për gjendjen e mjedisit, jep mbështetje shkencore dhe të tjera për përgatitjen e masave të mbrojtjes së mjedisit, llojllojshmërisë biologjike dhe natyrës, përgatitë programe dhe materiale edukative për ngritjen e ndërgjegjes publike për mjedisin.

Përmbushja e këtyre detyrave realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillim dhe mirëqenie afatgjate, duke mbrojtur mjedisin dhe sensibilizuar opinionin publik .

AKMM ka edhe këto detyra dhe përgjegjësi:

- Te siguroj informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës, që politika e mbrojtjes së mjedisit të zbatohet;
- Te zhvilloj dhe koordinoj sistemin unik të informimit për mbrojtjen e mjedisit të lidhur me sistemin e përcjelljes së gjendjes së mjedisit në Kosovë si dhe të mbledh shënimet për mjedisin;
- Te vendosë dhe të mbajë qendrat referente me bazat e shënimeve, lidhur me përcjelljen e mjedisit (shënimet socio-ekonomike, presionet në mjedis, gjendjen dhe kualitetin e mjedisit);

- Te zhvilloj procedurat për përpunimin e shënimeve të grumbulluara për mjedisin dhe vlerësimin e tyre (modelimin, prezantimin dhe paraqitjen vizuale);
- Te kryej punët profesionale - këshillëdhënëse gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës të përcjelljes të gjendjes së mjedisit, përcaktimin, mbajtjen dhe përcjelljen e projekteve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
- Te avancoj dhe krahasoj cilësinë e të dhënave për mjedisin;
- Te hartoj raporte për gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Kosovë, si dhe të raportojë për sektorët kryesor (ajrin, tokën, ujin, llojshmërinë biologjike, ndryshimet klimatike);
- Te hartoj raporte për lëmenj të caktuar për mbrojtjen e mjedisit siç janë rajonet me radioaktivitet të shtuar, cilësia e mjedisit, shëndeti dhe ngjashëm;
- Te ndihmoj organet e administratës në zhvillimin e formave të reja të politikës për mbrojtjen e mjedisit dhe përcjelljen e zbatimit të planeve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit
- Te bashkëpunoj me institucionet dhe organizmat tjerë të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e mjedisit;
- Te bashkëpunoj me personat juridik e fizik, organizmat ndërkombëtar, institucionet dhe shoqatat në hartimin dhe realizimin e projekteve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
- Te sigurojë dërgimin dhe qasjen në informata për mjedis duke shfrytëzuar teknologjitë moderne dhe standardet e komunikimit në pajtim me kërkesat evropiane;



Skema organizative e AMMK-së



Drejtoria e Monitorimit, Vlerësimin dhe Raportim Mjedisor

Njëra ndër shtyllat kryesore të AKMM është Drejtoria e Monitorimi, Vlerësimit dhe Raportimit mjedisor.

Kjo Drejtori përcakton orientimet dhe kriteret kryesore mbi monitorimin bazuar mbi standardet dhe indikatorët mjedisor Evropian dhe Kombëtar. Përcjell dhe merrë informacione nga presionet që i shkaktohen mjedisit nga sektorët e ndryshëm si energjetika, industria, transporti, agrikultura, pylltaria etj. Në mënyrë profesionale, dhe të bazuar në të dhëna të verifikuara kjo drejtori sjell informacione për gjendjen dhe kualitetin e ajrit, ujit, dheut, mbi gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit, mbi relacionet e mjedisit dhe shëndetit, mbeturinat si dhe informacione të tjera relevante.

Kjo drejtori përgatitë dhe organizon monitorimin në linjë me kërkesat e parashtruara nga MMPH-ja, planet strategjike dhe programet. Ofron të dhëna profesionale për monitorim sistematik, dhe në vazhdimësi, të gjendjes së mjedisit, vlerave natyrore, resurseve natyrore të vlerave të veçanta dhe ndikimi në shëndetësi në Kosovë.

Në vazhdimësi grumbullon të dhëna për parametrat mjedisorë dhe indikatorët e ndotjes dhe bën monitorimin e faktorëve natyrorë, ndryshimin e gjendjes mjedisore dhe kushtet në lidhje me ujin, ajrin, dheun, pyllin, biodiversitetin, zhurmën, vibrimin dhe mbeturinat. Kjo drejtori ka për qëllim të performojë analizat kimike, procedimin e të dhënave dhe informimit, përgatitjen e vlerësimeve dhe parashikimet e mëhershme të incidenteve të mundshëm mjedisorë. Drejtoria menaxhon verifikimin e instalimeve ndotëse, personat ligjorë dhe kompanitë private që kanë obligime ligjore në performimin e vetë monitorimit të emisioneve.

Është përgjegjëse po ashtu edhe për hartimin raporteve të përgjithshme dhe sektoriale për gjendjen e mjedisit, hartimin e planeve dhe programeve mjedisore si dhe përgatitjen e broshurave dhe materialeve tjera informative dhe edukative.

Drejtoria për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim është përgjegjëse edhe për bashkëpunim me Agjencinë Evropiane për Mbrojtjen e Mjedisit- EEA, dhe Rrjetin Evropian për Informim dhe Vëzhgim EIONET, si dhe me organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare. Kjo drejtori angazhohet edhe për ngritjen dhe avancimin e koncepteve të qëndrueshme zhvillimore në fushën e informimit dhe monitorimit të mjedisit si dhe përcaktimin dhe përcjelljen e projekteve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit si dhe projekteve për zvogëlimin e rrezikut, për ruajtjen e mjedisit si dhe monitoron implementimin e projekteve të ndryshme mjedisore.



Drejtoria e Parqeve Nacionale- Parku Nacional Mali Sharr

Parku nacional „Mali Sharr" është Parku i parë kombëtar i shpallur në Kosovë në vitin 1986. Funksionimi i Parkut Nacional ka filluar në vitin 1995, ndërsa është ndërprerë gjatë periudhës 1999 – 2002, dhe përsëri është riaktivizuar në maj të vitit 2002.

Parku nacional „Mali Sharr" Shtrihet në pjesën jugore të Republikës së Kosovës dhe shtrihet për gjatë kufirit me Republikën e Maqedonisë. Sipërfaqja e Parkut nacional, sipas Ligjit, është 39000 ha, e cila gjendet në territorin e katër komunave: Prizren (19 500 ha / 50%), Shtërpçë (15 210 ha / 39%), Suharekë (2 730 ha / 7%) dhe Kaçanik (1560 ha / 4%). Me Parkun nacional „Mali Sharr" menaxhon Drejtoria e Parkut Nacional me seli në Prizren, e cila funksionin në kuadër të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Drejtoria e Parkut Nacional „Mali Sharr" i kryen të gjitha funksionet që i takojnë menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore që kanë të bëjnë me planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollën.

Veprimtarit kryesore në kuadër të menaxhimit të resurseve natyrore janë: mbrojtja dhe zhvillimi i resurseve natyrore, hulumtimi dhe studimi i vlerave natyrore, shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i pasurive natyrore, kompletimi i infrastrukturës ligjore, organizative dhe financiare për menaxhimin e qëndrueshëm të Parkut nacional, etj. Drejtoria e Parkut Nacional me qëllim të mbrojtjes dhe menaxhimit më efikas të resurseve të Parkut bashkëpunon me shumë institucione. Puna e kësaj drejtorie është ngushtë e lidhur edhe me institucionet e tjera shtetërore siç janë: qeveritë qendrore dhe qeveritë komunale, policia, prokuroria, gjykata, inspektionet, emergjenca, brigada e zjarrfikësve.

Po ashtu kjo drejtoria bashkëpunon ngushtë edhe me institucionet joqeveritare siç janë shoqatat ekologjike, shoqatat e gjahtarëve, beshkatarëve, peshkatarëve etj. Drejtoria e Parkut Nacional „Mali Sharr" në përbërjen e vetë dy Sektorë: Sektorin e Pylltarisë dhe Sektorin e Biologjisë, të cilët i kryejnë punët nga fusha e tyre profesionale. Në kuadër të stafit Parkut nacional veçohen: stafi udhëheqës, profesional dhe administrativ - të cilit punët i kryejnë në zyre dhe në terren, dhe kujdestarët - të cilit vazhdimisht janë në terren me qëllim të kryerjes së aktiviteteve në mbrojtjen dhe vëzhgimin e resurseve natyrore (pyjeve, florës dhe faunës).

Parku nacional menaxhohet në bazë të Ligjit për Parkun Nacional „Mali Sharr" GZ KSAK 11/86. Ligjet e tjera mbështetëse për menaxhimin e Parkut nacional janë: Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për pyjet dhe Kodit Penal i Republikës së Kosovës. Menaxhimi i Parkut nacional rregullohet edhe përmes Planit Hapësinor për Parkut Nacional dhe Planit Menaxhues për Parkut Nacional.



Instituti për Mbrojtjen e Natyrës

Instituti i Kosovës për mbrojtjen e natyrës është institucioni qendror për ruajtjen e natyrës, monitorimin e gjendjes së vlerave të mbrojtura natyrore në Kosovë.

Në vitin 1968 formohet njësia për mbrojtjen e natyrës në kuadër të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës. Me vendimin mbi ndarjen e Seksionit për Mbrojtjen e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, u themelua Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe vazhdoi punën me të njëjtin emër, sipas Ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Ndërsa në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerr ligjin për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të Krijuara me Punë të Ambientit të Njeriut ku në nenin 78 paragrafi 2 të këtij Ligji është përcaktuar veprimtaria e Enti. Në bazë të këtij Ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerr Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit. Pas luftës, me krijimin e rrethanave të reja të qeverisjes në Kosovë, në bazë të Rregullores 1999/1 "i gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë i vihet UNMIK-ut".

Në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së me emërtimin " Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës" me seli në Prishtinë. Në vitin 2001 me formimin e organeve qeverisëse të Kosovës, formohet edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Instituti për Mbrojtjen e Mjedisit bëhet pjesë e kësaj ministrie, ndërsa në vitin 2006 me themelimin e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, ai kalon si njësi e këtij agjencioni në kuadër të së cilit vepron edhe tani.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në kuadër të veprimtarisë së vetë kryen punët profesionale në mbrojtjen e natyrës që kanë të bëjnë me:

- mbledhjen dhe përpunimin e shënimeve lidhur me mbrojtjen e natyrës;
- hartimin e bazave afatgjata profesionale të mbrojtjes për llojet e bimëve, kërpudhave dhe shtazëve, tipave të vendbanimeve, ekosistemeve dhe peizazheve;
- monitorimin e gjendjes së larmisë biologjike dhe peizazhore dhe propozon masat për mbrojtjen e tyre;
- përgatitjen e bazave profesionale për mbrojtjen dhe ruajtjen e pjesëve të natyrës, përkatësisht vlerave të natyrës;
- hartimin e bazave profesionale për nevojat e përcaktimit të kushteve për mbrojtjen e natyrës, menaxhimin me zonat e mbrojtura dhe shfrytëzimi i të mirave të natyrës;
- kryerjen e analizave statistikore dhe unifikimin e rezultateve si dhe hartimin e raportit për gjendjen dhe mbrojtjen e natyrës;
- pjesëmarrjen në zbatimin e akteve ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës.



Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës apo shkurt IHMK është instituti që bënë matjet hidrometeorologjike në territorin e Kosovës si dhe monitorimin e cilësisë së ajrit.

Veprimtaria Hidrometeorologjike në Kosovë ka filluar në vitin 1922 kur në kufirin shqiptaro-shqiptar në Vermicë është vendosur një latë (hidrometer) dhe limnigraf në lumin Drini i Bardhë. Po në atë pikë monitoruese datojnë edhe matjet e para klimatologjike.

Rrjeti aktual i monitorimit të ujërave është i shtrirë sipas ujërrjedhave përkatësisht pellgjeve ujore të Kosovës, kurse stacionet meteorologjike janë të shpërndara sipas gjerësisë gjeografike me qëllim të evidentimit dhe saktësisë të elementeve dhe dukurive meteorologjike.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës menaxhon edhe me rrjetin e stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit.

Ky institut në kuadër të tij ka **Sektorin e Meteorologjisë** i cili kryer natjet meteorologjike dhe agrometeorologjike, **Sektorin e Hidrologjisë** i cili bënë monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe **Sektorin e Laboratorit** i cili kryen analizat fiziko kimike të ujërave, dheut dhe cilësisë së ajrit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të IHMK-së janë:

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit themelor të stacioneve hidrologjike dhe meteorologjike dhe organizimi i matjeve dhe vërtetimit të elementeve dhe dukurive: hidrologjike, meteorologjike, biometeorologjike dhe hidrobiologjike.

Studimi, përpunimi, ruajtja, këmbimi dhe shpallja e të dhënave dhe rezultateve hidrometeorologjike dhe rezultateve të hulumtimeve në rrjetin e monitorimit. Organizimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i sistemit llogaritës, vërtetues të bazës së të dhënave e të prognozimit për kryerjen e punëve hidrometeorologjike.

Kryerja e matjeve, vërtetimit meteorologjike me radar si dhe kryerja e matjeve dhe vërtetimit hidrometeorologjike sistematike në ujërrjedhat e lumenjve në rastet e zakonshme dhe në rastet e çrregullimeve, të gjendjes së ujërave të nëntokës në zonën e ngopur dhe në kontakt të drejtëpërdrejt me tokën dhe nëntokën.

Përcjellja sistematike dhe konstatimi i ndotjes së ajrit, të reshurave atmosferike, ujërave sipërfaqësore dhe ujërave të nëntokës të burimit të parë dhe tokës, studimi dhe prognozimi i kushteve hidrometeorologjike të ndotjes së mjedisit si dhe paralajmërimi i paraqitjes së fatkeqësive elementare hidrometeorologjike.

Dhënjat e raporteve, parashikimeve dhe paralajmërimeve të organeve kompetente qëndrore dhe lokale mbi dukuritë hidrometeorologjike dhe studimi i motit, klimës, ujërave sipërfaqësore dhe të nëntokës, si dhe ndikimit të tyre në biosferë.

Hulumtimi i ndryshimeve të motit, klimës, ujërave të shkaktuara nga ndikimi artificial si dhe studimi i metodave të veprimeve artificiale mbi motin, klimën dhe ujërat.



Instituti për Planifikim Hapësinor

Instituti për Planifikim Hapësinor është pjesë përbërëse e AMMK-së. Është themeluar në Tetor të vitit 2003 me akt të veçantë.

Veprimtaria kryesore e këtij institucioni është hartimi i Planit Hapësinor të Kosovës dhe përgatitja dhe hartimi i planeve të zonave me përmbytje të veçantë dhe me interes për shtetin. Veprimtari tjetër e rëndësishme është ngritja e kapaciteteve humane dhe ndihma teknike profesionale e punëtorëve të nivelit komunal në procesin e planifikimit në nivelin lokal me përcjelljen e procesit dhe dhënjen e kontributit për prodhimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor lokal sikur janë Planet Zhvillimore Komunale.

Si rezultat i punës së këtij Instituti deri me tani janë prodhuar dokumente të rëndësishme dhe të nevojshme për sektorin e planifikimit hapësinor në veçanti dhe dokumente të rëndësishme për Qeverinë e Kosovës në përgjithësi.

Prej këtyre dokumenteve më i rëndësishmi është Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020.

IPH e ka përfunduar edhe hartimin e disa planeve hapësinore për zona të veçanta si: Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar "Mali Sharr", Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Fusha e Mihjes së Re" dhe Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë "Kleçkë dhe Divjakë".

Hartimi i Planit Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik "Hidrocentrali Zhur" është në fazën përfundimtare, kurse në fazën e zhvillimit është edhe Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës".





Përveq planeve hapësinore, IPH ka prodhuar edhe një sërë dokumentesh tjera sikur janë analiza hapësinore për komunat: Suharekë, Vushtrri, Sharr, Kaçanik, Malishevë, Kamenicë dhe Obiliq. Këto analiza hapësinore kanë qenë një ndihmë e madhe për këto komuna në hartimin e planeve të tyre zhvillimore.

Një punë e rëndësishme e Institutit ka qenë hulumtimi që është bërë në fushën e vendbanimeve joformale. Në bazë të rezultateve të hulumtimit të zhvilluar në disa komuna, është nxjerrë udhëzuesi për trajtimin e këtyre vendbanimeve.

Veprimtari tjetër e rëndësishme e IPH-së është edhe bashkëpunimi me institucione, organizata dhe individë profesionistë vendorë dhe të huaj. Bashkëpunimi është realizuar dhe realizohet në formën e ardhjes së konsulentëve të huaj për trajnimin e stafit të IPH-së, pjesëmarrjes së stafit të IPH-së në takime, seminare e konferenca të ndryshme me karakter vendor e ndërkombëtar apo në involvimin e IPH-së në realizimin e projekteve të inicuar nga organizata të ndryshme vendore dhe të huaja.



Publikime nga AMMK



Bashkëpunimi me Agjencionin Evropian të Mjedisit

Në Mars të vitit 2010, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit ka filluar bashkëpunimin me Agjencinë Evropiane të Mjedisit në kuadër të projektit “Pjesëmarrja e vendeve të Ballkanit Perëndimor në punën e Agjencionit Evropian të Mjedisit”.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi deri me tani janë organizuar këto aktivitete:

- Është caktuar NFP (National Focal Point) dhe është Zhvilluar rrjeti i NRC (National Reference Centres) për 23 qendra referente,
- Pjesëmarrje në dhjetëra workshope, seminare, trajnime dhe takime të organizuar nga EEA dhe EIONET,
- Janë dorëzuar këto Raporte: Raporti për për emisionet në ajër, Raporti për zonat e mbrojtura, Raporti për gazrat serë, Raporti për cilësinë e ujërave të lumenjëve dhe Raporti mujor i Ozonit.
- Janë shkëmbyer informacione dhe përvoja për raportet, politikat dhe të arriturat në lëmin e mjedisit.
- Janë postuar në ueb faqen e EIONET (SERIS dhe AoA) dhjetëra Raporte për gjendjen e mjedisit në Kosovë, Raporte sektoriale, Vlerësime dhe dokumente strategjike

Donatorë e aktiviteteve të AMMK-së

Disa nga rezultatet e deritanishme të AMMK-së janë arritur në saje të mbështetjes dhe përkrahjes së ofruar nga donatorët e ndryshëm. Për mbështetjen e ofruar Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës falënderon më mënyrë të veçantë Komisionin Evropian dhe Zyrën Ndërlidhëse të tij në Kosovë, Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) zyrën në Kosovë dhe GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) projekti në Kosovë.

Konferencat të organizuara nga AMMK

Me ndihmën e donatorëve dhe përkrahjen e institucioneve tjera AMMK ka organizuar disa konferenca si:

- Mbrojtja e Mjedisit përmes Efiçencës së Energjisë 2006,
- Monitorimi dhe Raportimi Mjedisor, Nevojat dhe Mundësitë 2007.
- Praktikat, Mundësitë, Veprimet- Mbrojtja e Mjedisit dhe Efiçenca e Energjisë 2008.



“Në Kosovën e re, me energji të pastër dhe mjedis të shëndetshëm”

**Mbrojtja e Mjedisit dhe Efiçenca e Energjisë
Praktikat, mundësitë, veprimet
KONFERENCË NDËRKOMBËTARE
PRISHTINË, KOSOVË, 20 – 21 TETOR 2008**

Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje për Sektorin e Mjedisit”



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) është përfituese e një projekti Binjakëzimi të BE të quajtur “Mbështetje për Sektorin e Mjedisit në Kosovë”. Ai është një projekt i financuar nga BE me kohëzgjatje prej 22 muajsh, me një buxhet prej 1.0 m € dhe 0.1 m € të bashkëfinancimit nga Buxheti Shtetëror i Kosovës. Për të përmirësuar gjendjen e mjedisit në

Kosovë tashmë janë ndërmarr një numër i përpjekjeve nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Në lidhshmëri me përpjekjet për të filluar me implementimin e Politikave Mjedisore të BE-së dhe parapërgatitjet për shfrytëzim në të ardhmen të Komponentit për Zhvillimin e Mjedisit të IPA-s, AMMK ka për të futur politika dhe mjete të reja dhe të rëndësishme në mbështetje të reformave dhe zhvillimet e përgjithshme, sektoriale dhe institucionale. Ky projekt do të implementohet nga ana e Agjencisë së Mjedisit, Austri, Umweltbundesamt (UBA), në bashkëpunim me eksperte nga Instituti Meteorologjikë Finlandez dhe Qendra për Mjedis, Gjeologji dhe Meteorologji e Letonisë. Këto tri Shtete tashmë kanë kaluar procesin e pranimi në BE dhe kanë implementuar me sukses projekte të ngjashme Binjakëzimi në Evropën Lindore dhe Juglindore. Agjencia për Mbrojtje e Mjedisit e Kosovës pret që ky projekt do të jetë një rast historik për përgatitjen e rrugës së Kosovës për në BE.

Objektivi i përgjithshëm i këtij Projekti të Binjakëzimit është përmirësimi i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i kushteve mjedisore përfshirë cilësinë e ajrit, menaxhimi dhe kontrollimi i burimeve të ujit për t'i plotësuar standardet e BE, në veçanti në lidhje me shëndetin publik dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Qëllimi i projektit është i fokusuar mbi mbështetjen e mëtutjeshme institucionale për Sektorin e Mjedisit në Kosovë.

Rezultatet kryesore të pritura nga projekti janë:

- Konsolidimi i kapaciteteve administrative në AMMK dhe në departamentet relevante në MMPH në çështje ligjore, institucionale dhe teknike të monitorimit të mjedisit me fokusim të veçantë mbi ajër dhe ujë.
- Kapacitete të përmirësuara të AMMK për të përmbushur të paktën 30 % e kërkesave të raportimit për Agjencinë Evropiane të Mjedisit për treguesit e prioritetit të rrjedhës së të dhënave (ajër, ujë, mbrojtje të mjedisit)
- Strategji e hartuar për ngritjen e vetëdijesimit publik dhe materiale në disponueshmëri Krijimi i menaxhimit moderne të të dhënave përfshirë dhe zhvillimin e bazës së të dhënave

Projekti është i ndarë në 4 komponente kryesore.

- Komponenti 1 “Mbështetje Institucionale, ligjore dhe teknike për AMMK dhe departamentet relevante të MMPH në përmirësimin e kapacitetet të tyre për të menaxhuar dhe vazhduar aktivitetet e monitorimit që lidhen me çështjet kryesore të mjedisit përfshirë ujin dhe cilësinë e ajrit, mbrojtjen e natyrës etj”
- Komponenti 2 “Mbështetje në përgatitjen e Raportit Shtetëror të Mjedisit dhe në përmirësimin e bashkëpunimit me Agjencinë Evropiane të Mjedisit”
- Komponenti 3 “Mbështetje për shqyrtimin procedimit të të dhënave, menaxhimin e të dhënave dhe për përgatitjen e bazës së të dhënave”
- Komponenti 4 “Mbështetje në përgatitjen e strategjisë për ngritjen e vetëdijesimit publik dhe për elaborimin e materialeve”.



Buletini Mjedisor

Buletini Mjedisor është një publikim i rregullt informativ i cili realizohet si bashkëpunimit në mes të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimi (UNDP). Nevoja për të rritur nivelin e informatave kualitative për mjedisin ka qenë njëra prej arsyeve që ka nxitur publikimin e këtij buletini. Synimi kryesor i këtij buletini është të sjellë tek dashamirët e mjedisit informata me rëndësi për mjedisin por edhe të pasqyrojë angazhimet, përpjekjet dhe aktivitetet e institucioneve mjedisore, organizatave jo qeveritare mjedisore dhe të iniciativave qytetare për përmirësimin e gjendjes së mjedisit. Në faqet e buletinit i cili publikohet çdo tre muaj zënë vend edhe këshilla të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit, kuriozitete për mjedisin, ngjarje nga kalendari mjedisor botëror por edhe fakte të rëndësishme mjedisore. Deri me tani janë botuar tre numra të kësaj magazine informative.

Ueb faqja e AMMK-së

Ueb faqja zyrtare e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës www.ammk-rks.net, është pjesë shumë e rëndësishme e punës dhe aktiviteteve të AMMK-së. Në këtë faqe e cila është në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze vizitorët mundë të gjejnë informacione të ndryshme. Këtu mundë të gjeni informatat për aktivitetet e AMMK-së, publikimet dhe raportet e AMMK-së, prezantime, materiale dhe të dhëna tjera për gjendjen e mjedisit. Vizitorë të ueb faqes sonë janë studentët, hulumtuesit, donatorët, organizatat huaja, institucionet vendore qeveritare dhe joqeveritare dhe shumë klientë të tjerë që kërkojnë informata cilësore për mjedisit.



Foto nga aktivitetet e AMMK-së



Shënimi i ngjarjeve mjedisore



Ekspedita hulumtuese



Hapja zyrtare e projektit të Binjakezimit



Pjesëmarrje në aktivitetet e EEA



Bashkëpunimi Rajonal



Bashkëpunimi me OJQ



Eko shkolla verore



Debate dhe promovime



Marrëveshje bashkëpunimi



Vizita studimore



Konferenca ndërkombëtare



Hulumtime shkencore

*“Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare
janë përgjegjësi e secilit”*

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 51.1



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
(Një profil i shkurtër)

Ballina- Peisazh nga Malet e Sharrit

Fotografitë- Bukuritë Natyrore të Parkut Nacional “Mali Sharr”

*Adresa: Rruga “Luan Haradinaj” Ndërtesa e re e Qeverisë së Kosovës
Ish Pallati i mediave “Rilindja”, kati XV/04*

Telefoni: +381 38 200 33 228

Email: kepa@ks-gov.net

www.ammk-rks.net

Prishtinë, 2011